



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1104/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Ardita Kozmaqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1104/2021 i datës 08.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Ardita Kozmaqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 08.11.2021 të dërguar nëpërmjet Postës së Kosovës me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Ardita Kozmaqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Gjilan, me të cilën pretendon se në shkollën fillore Abaz Ajeti në Gjilan 401 D klasa, vendvotimi 12-13-14, nuk i kane dalur votat e familjes së burrit si dhe në vendvotimi në fshatin Përlepnicë shkolla fillore Skënderbeu i mungojnë votat e familjes së hallës së burrit, supozon se gjatë numërimit të votave ka pasur manipulim nga ana e komisionereve.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidaten në

fjalë, për faktin se thëniet e saja janë vetëm supozime dhe sipërfaqësore dhe jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për të cilën ajo pretendon në mos numërimin dhe mungesë të votave.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Ardita Kozmaqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Gjilan, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave për vendvotimet e lartcekura.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.1104/2021 më datën 09.11.2021**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.